

Ditari Naturës



Nr. 46 Viti i pestë i botimit Mars 2017

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- Takim Përmbyllës në kuadër të projektit “Aktivitete të Qëndrueshme Ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut; Shqipëria
- Formohet Grupimi “Të shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë”
- Memorandum Mirëkuptimi midis CO-SEED dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit
- INCA merr pjesë në konferencën përmbyllëse të projektit “Ruajtja e Pelikanëve, specie me rëndësi për liqenin e Shkodrës
- Pse proteston Zharrësa / nga Qendra EDEN
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se
17 vjet më parë ...

...me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.82, datë 02.03.2000 shpallet Park Kombëtar, në mbrojtje të shtetit, zona arkeologjike e Butrintit, me sipërfaqe 25 km².


Bazuar në rekomandimet e disa studime të kryera për këtë territor, kompleksi natyror ligatinor i Liqenit të Butrintit dhe rrethinat e tij, përfshi edhe kepin e Stillos, me VKM nr.693, datë 10.11.2005, u rishpall Park Kombëtar, me sipërfaqe të zgjeruar prej 8,591.2 ha.

Vijon në faqe 2



Parku Kombëtar i Butrintit © Foto INCA

Organizatrat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHOQATA MJEDISORE CAJUPI
Bashkejeto me Natyrën



Vijon nga faqe 1

Në kuadrin e projektit të Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare (ICZMCP), u hartua dhe plani i menaxhimit të PK të Butrintit, i cili u miratua, sipas dispozitave të ligjit "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, me urdhrin nr.404, datë 09.06.2011 të ministrit të Mjedisit. Mbi bazën e rekomandimeve të planit të menaxhimit, me VKM nr.134, datë 20.02.2013, sipërfaqja e parkut u zgjeruar në 9,424.4 ha, nga e cila 883.2 ha është zonë detare.

Territori natyror i kompleksit ligatinor të Butrintit (ku u përfshinë Liqeni i Butrintit, zona arkeologjike e PK të Butrintit, Kepi i Stillos dhe ishujt e Ksamilit), me sipërfaqe të përgjithshme prej 13,500 ha, me VKM nr.531, datë 31.10.2002, shpallet zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur, për t'u përfshirë në listën e Konventës (Ramsar) "Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë"...


...8 vjet më parë ...

...me VKM nr.241, datë 06.03.2009 miratohet "Lista e llojeve të huaja invazive dhe për përcaktimin e procedurave, për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në pikat doganore të vendit". Sipas këtij vendimi...Ndalohet futja në territorin e Republikës së Shqipërisë të llojeve të huaja invazive, sipas përcaktimit të shtojcës I... Ndalimin e futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të ekzemplarëve të rinj, të llojeve të huaja, me shkallë invazioni 3, sipas shtojcës II...Lejimin ose ndalimin, për rastet e tjera, të një lloji të huaj, për t'u importuar ose për t'u introduktuar në territorin e vendit tonë, mbështetur në vlerësimin e rrezikut, që mbart importimi ose introduktimi i tij, i cili vlerëson shkallën e invazionit të llojit të huaj...Vlerësimi i rrezikut të një lloji të huaj është vlerësimi i pasojave të introduktimit dhe mundësisë së instalimit të një lloji të huaj, duke përdorur informacionin shkencor. Menaxhimi i rrezikut përcakton masat, që duhen zbatuar për t'i reduktuar ose menaxhuar rreziqet e identifikuar gjatë vlerësimit të rrezikut... Mos lejimin, nga administrata doganore, e futjes, në territorin doganor, të llojeve të huaja, kur subjektet nuk janë të pajisura me leje....etj...

...7 vjet më parë ...

...miratohet Ligji nr.10253, datë 11.03.2010 "Për gjuetinë". Ky ligj ka për qëllim: a) përcaktimin e rregullave e të kërkesave për zhvillimin e gjuetisë, si një veprimtar tradicionale, sportive, çlodhëse dhe turistike; b) menaxhimin e qëndrueshëm të gjuetisë, duke e vlerësuar faunën e egër si pasuri kombëtare që administrohet dhe mbrohet me ligj; c) garantimin që parimet për gjuetinë të zbatohen në mënyrë rigorozë, duke ruajtur tërësinë e ekosistemit dhe baraspeshën ekologjike; ç) mosdëmtimin e llojeve të faunës së egër e të habitateve të tyre gjatë ushtrimit të gjuetisë; d) respektimin e së drejtës së gjuetisë dhe të të drejtave mbi gjahun, mbi trofetë e produktet e gjuetisë dhe të tregtimit të tyre...

AKZM me strukturat e saj të vartësisë, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdesshme që të evidentojnë dhe të marrin masa për krenntimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqe të re në punën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.



Takim përmbyllës në kuadër të projektit “Aktivitete të Qëndrueshme Ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut”

Vlorë, 3 Shkurt 2017 - Ditën e premte në ambientet e Hotel Miramare në Vlorë, INCA organizoi takimin përmbyllës të projektit “Aktivitete të Qëndrueshme Ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut - SEA-Med” mbështetur nga WWF MedPO dhe CEPF.

Aktiviteti mbledhi bashkë të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët e projektit, si

përfaqësuesit e pushtetit vendor dhe lokal, OJF-të lokale dhe operatorët lokal të turizmit, përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit, asaj të Turizmit, AKZM, UNDP, Këshillit të Qarkut dhe

Bashkisë Vlorë, Njesisë Administrative Orikum, AdRZM Vlorë, Universitetit të Vlorës etj. Takimi synoi të risjellë në vëmendjen e partnerëve arritjet kryesore të projektit, aktivitetet, sfidat dhe perspektivë e ardhshme. Gjithashtu

gjatë aktivitetit u mbajt edhe një seancë ku çdo partner pati mundësinë të ndajë përvojën e tij në këtë projekt. Në fund të takimit u organizua një ekspozitë fotografike nga aktivitetet kryesore të projektit si dhe performanca e



fëmijëve të Shkollës 9-Vjeçare Orikum me valle tradicionale të zonës, ia shtoi akoma më shumë bukurinë.



Aktiviteti u përshëndet edhe nga Ansambli Polifonik Çipini me kënge tradicionale dhe bejte.



Formohet Grupimi “Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë”

Tiranë, 17/02/2017 - INCA në bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare Katër Putrat, si dhe me institucione e tjera aktive dhe ECSO-s, janë duke punuar së bashku kundër keqtrajtimit të kafshëve të egra si dhe kundër robërisë së tyre, me në fokus ariun e murmë, si specien më të rrezikuar në robëri.



Aktualisht, në Shqipëri janë rreth 40-50 arinj të murmë që mbahen në robëri, ndërsa ende nuk ekziston një bazë të dhënash zyrtare për kafshë të egra të tjera të mbajtura në mënyrë të paligjshme. Trafikimi dhe tregtia e paligjshme e arinjve të murmë është ende aktive edhe pse legjislacion aktual dhe konventat ndërkombëtare e ndalojnë absolutisht këtë. Gjatë vitit 2016, Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me aktivistë kombëtare dhe ndërkombëtarë, lehtësuan procedurat për shpëtimin e rreth 20 arinjve dhe transferimin e tyre jashtë vendit, në

parqe të specializuara natyrore, në kushte gjysmë lirie (Itali, Gjermani, Kosovë, Bullgaria dhe Greqia).

Edhe pse disa përpjekje janë bërë dhe disa rezultate konkrete janë arritur, institucionet qeveritare dhe opinioni publik ende nuk janë të ndjeshëm mjaftueshëm për të siguruar një zgjidhje afatgjatë. Për këtë arsye, ECSOs dhe aktivistët kanë intensifikuar përpjekjet për gjetjen e një mënyrë të qëndrueshme jashtë. Në këtë kuadër, një numër i organizatave vendore, duke përfshirë edhe AKZM dhe Katër Putrat, formuan koalicionin “Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë”. Qëllimi i koalicionit është që të rrisë ndërgjegjësimin e publikut, të ndikojnë për vënien në zbatim si dhe gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për kafshë të egra në robëri, zbatimin e ligjit, përmirësimin e legjislacionit dhe ndërtimin e qendrave të specializuara të rehabilitimitit.



Memorandum Mirëkuptimi midis CO-SEED dhe AKM

Në kuadër të zbatimit të projektit CO-SEED “Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social-Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm”, INCA në bashkëpunim me organizatat përfituese të grantit për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve (të dhënë nga projekti CO-SEED) Qendra EDEN dhe Mllieukontakt Shqipëri, realizuan në datë 15.02.2017, nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit me bashkëpunëtorin kryesor të projektit dhe të procesit të vlerësimit të VNM në shkallë kombëtare, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, në mjediset e saj. Memorandumi i nënshkruar që ato do të zbatojnë, ka për qëllim të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve

natyrore përmes përmirësimit të kuadrit rregullator dhe të nxisë më shumë pjesëmarrje



Vijon nga faqe 4

dhe transparencë në proceset e vendimmarrjes mjedisore (VNM dhe VSM) me përfitime për shoqërinë në përgjithësi.

Memorandumi ka si qëllim bashkëpunimin për:

- Pjesëmarrje aktive në procesin e vlerësimit të VNM të organizuara nga AKM për projekte me ndikim mjedisor;
- Pjesëmarrje aktive në proceset e konsultimit me publikun në diskutimet e VNM të organizuara nga AKM/ARM;

- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si takime dhe/ose tryeza pune, me pjesëmarrjen e specialistëve të të dyja Palëve, për përmirësimin e procesit;
- Publikimi dhe/ose shkëmbimi zyrtarisht i të dhënave dhe informacioneve, për përmirësimet në legjislacionin dhe vendimmarrjen në Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis (VNM).

INCA merr pjesë në konferencën përmbyllëse të projektit “Ruajtja e Pelikanëve, specie me rëndësi për liqenin e Shkodrës”

Parku Kombëtar Liqeni i Shkodrës / Mali i Zi, 27/02/2017 - U mbajt në Parkun Kombëtar Liqeni i Shkodrës në Malin e Zi, Konferenca e fundit për Shtyp e projektit “Ruajtja e Pelikanëve, specie me rëndësi për liqenin e Shkodrës” financuar nga CEPF dhe MAYA.

Përfaqësuesit e Ndërmarrjes Publike të Parqeve Kombëtare në Malin të Zi si dhe partnerët e projektit prezantuan rezultatet kryesore të tij në lidhje me mbrojtjen e pelikanëve si dhe të gjithë pjesëmarrësit patën mundësinë për të parë koloninë e pelikanëve në një rezervë të



veçantë siç është ajo e Malit të Zi. Koordinatorja e projektit znj. Bjanka Praljacici në fjalën e saj tha se nga viti në vit numri i pelikanëve është rritur ndjeshëm, që tregon se kolonia është e qëndrueshme.

Ndërsa Drejtori i Ndërmarrjes Publike të Parqeve Kombëtare në Malin të Zi, znj. Azra Yukoviç tha se ky projekt po zbatohet që nga 2013 për të mbrojtur habitatin e pelikanëve në Parkun Kombëtar Liqeni i Shkodrës dhe se ne jemi shumë krenarë për rrezultatet e këtij projekti. Ykoviç tha se ajo shpresonte se në periudhën

në vazhdim, në bashkëpunim me donatorët, OJQ-të dhe institucionet e tjera, do të vazhdojmë aktivitetet që lidhen me ruajtjen e biodiversitetit të habitateve dhe biodiversitetit të Liqenit të Shkodrës.

Në aktivitet ishte e ftuar edhe INCA si institucioni i cili është duke zbatuar në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta projekte në lidhje me këtë specie veçanërisht të mbrojtur, Pelikani Kaçurrel.



Pse Proteston Zharrës / nga Qendra EDEN

Në 27 shkurt 2017 banorë të Zharrzës ndërmorën një marshim 4 ditor nga fshati i tyre drejt Tiranës me qëllimin për tërhequr vëmendjen e qeverisë shqiptare dhe atë të medias gjithashtu, të cilët për hir të së vërtetës e kanë lënë thuajse në hije këtë rast. Marshimi nisi fillimisht me grevë urie të 7 personave në Zharrës ku pati vetëm reagim mediatik dhe anjë hap më tej nuk u ndërmorë. Qendra mjedisore EDEN e ka ndjekur rastin që prej vitit 2011 duke dalë me rekondime konkrete (2014) për të minimizuar problematikat në zonë dhe duke i adresuar të gjitha shqetësimet e banorëve edhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Situata pati përmirësime të dukshme në sinjalistikën e rrugëve ku automjetet e punës kalonin në afërsi të zonave të banuara.

Në 1 Prill 2015 gjatë veprimtarisë hidrokarbure të "Bankers Petroleum Albania Ltd" (Bankers) në pusin e naftës nr.5761 ka ndodhur fontana (shpërthimi i këtij pusi) e cila ka shkaktuar ndotje të mëdha në ajër dhe dëme të konsiderueshme në tokat e banorëve që jetonin aty pranë. Një Komision i posaçëmme përfaqësues të ish Komunes Kuman, Këshillit të Qarkut Fier dhe të Bankers, u ngrit për të verifikuar dëmet e shkaktuara. Komisioni vendosi dhënie të ndihmës financiare prej 248 861 366. 72 lekësh me TVSH për vetëm 48 pronarë objektësh në zonë. Banorët shpesh pakënaqësi dhe kërkojnë vazhdimisht mbështetjen e Bashkisë së Roskovecit për adresimin e problemeve të tyre.

E ndodhur para një situatë të tillë, me qytetarë të pakënaqur, si dhe në mungesë të mirëfilltë bashkëpunimi me Bankers, Bashkia e Roskovecit përfaqësues të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile për të trajtuar situatën dhe ndërmarrë masa të zgjidhjes së disa prej ngërçeve të krijuara. Në këtë frymë, më datë 10/01/2016 Bashkia Roskovec nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Qendrën EDEN. Qëllimi i këtij bashkëpunimi ishte njohja e komunitetit me mekanizmat e ankimimit dhe për adresuar problemet e tyre. Pas disa takimeve që Qendra EDEN zhvilloi në zonë me komunitetin e prekur dhe me përfaqësues të Bankers

Petroleum, u konstatua se situata në këto zona është shumë më problematike dhe e rënduar seç paraqitet dhe tërmetet e shkaktuara nga shpërthimet janë një nga shumë shqetësimet që banorët sfidojnë çdo ditë dhe me të cilat u duhet të bashkëjetojnë. Kjo u vu re edhe nga analizat e ujit të pijshëm që EDEN analizojë në disa familje të zonës ku u evidentua që parametrat fiziko-kimikë të analizuar ishin jashtë normës kufij sipas standardit shqiptar dhe atij evropian. Si nevojë e vazhdueshme e komunitetit mbetet nevoja për të patur rezultate të pavarura nga rezultatet e paraqitura nga Bankers të parametrave të cilësisë së ajrit, i cili konstatohet nga banorët si shumë i ndotur dhe që ndikon drejtpërdrejtë në shëndetin e tyre.

Gjithë komuniteti ndodhet përpara një situatë të ndërlikuar, por mbi të gjitha jetike, të cilat nisuar nga puna e Qendrës EDEN në zonë dhe mbështetur në deklaratat e banorëve, lidhen me:

- Probleme shëndetësore që vijnë nga ndotjet në ajër-ujin e pijshëm dhe në tokën bujqësore;
- Ndotje të ujit dhe infrastrukturë jo efektive ujore;
- Numër thuajse i papërfillshëm i individëve që janë punësuar dhe punojnë për Bankers;
- Mungesë në investime sociale;
- Shtëpi të rrënuara prej tërmeteve;
- Mungesë të konsultimeve, ose konsultime jo gjithëpërfshirës të banorëve të zonës;
- Mungesë bashkëpunimi efikas mes Bashkisë së Roskovecit-qytetarëve-Bankers;
- Mungesa e institucioneve shtetërore që të mbajnë përgjegjësi dhe të marrin masa konkrete për problematikat e zonës;
- Dëmshpërblime të bëra në mënyrë të padrejtë.

Në një situatë të tillë banorët e Zharrzës, gjetën si të vetme rrugë për tu dëgjuar dhe për të adresuar problemet e tyre protestën në Tiranë, aty ku institucionet shtetërore veprojnë. Qendra EDEN mbështet fort iniciativën e tyre dhe do të vazhdojë punën e saj për të adresuar problemet e komunitetit organeve përgjegjëse. Urojmë që kjo protestë të marrë zgjidhje sa më

Vijon në faqe 7

Vijon nga faqe 6

të shpjgjetë, duke zhvilluar hapa konkrete për përmirësimin e saj dhe veçanërisht veprime afatëgjata për të mos pasur më përsëritje të tilla në zonë.

Qendra EDEN ka zhvilluar dhe një video “Të jetosh afër naftës nuk do të thotë të jetosh në ferr”, me reagime të drejtpërdrejta të qytetarëve që mund ta shihni duke klikuar këtu <https://www.youtube.com/watch?v=TlnlQxcudH8>



Coalition
SAVE ALBANIAN BEARS

**GRUPIMI
TË SHPËTOJMË
ARINJTË
SHQIPTARË**

**...born to be
FREE !**

**17 Shkurt 2017
TIRANË**

**...LINDUR PËR TË
JETUAR I LIRË !**

AKZM INCA

NJOFTIME

- 3 Mars - Dita Botërore e Jetës së Egër
- 5 Mars - Dita Botërore e Eficiencës së Energjisë
- 14 Mars - Dita Ndërkombëtare e Veprimit për Lumenjtë
- 21 Mars - Dita Ndërkombëtare e Pyjeve
- 22 Mars - Dita Botërore e Ujit
- 23 Mars - Dita Botërore e Meteorologjisë
- 28 Mars - Ora e Tokës

2 - Për të lexuar “*Ditari i Natyrës*” në vite... / <http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme. Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, 1001, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania